



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. /2023

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS NXITËSE MAKSIMALE, PREMIUMIT FIKS DHE ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në nenin 8 paragrafi 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 dhe nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, neni 15, neni 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 4. të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur më _____ miratoi si në vijim:

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS NXITËSE MAKSIMALE, PREMIUMIT FIKS DHE ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo metodologji përcakton procedurën për përcaktimin e tarifës nxitëse maksimale, premiumit fiks dhe çmimit të fiksuar maksimal për skemat mbështetëse për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, të zbatuara përmes një procesi të tenderimit konkurrues.
2. Kjo metodologji përcakton:
 - 2.1. Parimet bazë sipas të cilave do të llogaritet premiumi i fiksuar maksimal, çmimi i fiksuar maksimal dhe tarifa nxitëse maksimale ose çmimi i garantuar i blerjes; dhe,
 - 2.2. Metodën për llogaritjen e tarifës nxitëse maksimale, premiumit të fiksuar maksimal dhe çmimit të fiksuar maksimal.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

1. Termat e përdorur në këtë rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:
 - 1.1. Procesi i tenderit konkurrues - nënkupton një proces tenderimi transparent, jodiskriminues që parashikon pjesëmarrjen e një numri të mjaftueshëm kompanish dhe ku mbështetja financiare ndahet në bazë të ofertave më të suksesshme të paraqitura nga ofertuesit në një proces konkurrues;
 - 1.2. Kontrata e diferencës – nënkupton një lloj Kontrate për Mbështetje të caktuar financiarisht, me anë të së cilës një premium rrëshqitës, i përbërë nga diferenca ndërmjet çmimit referent dhe çmimit të fiksuar, caktohet në mes të Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme dhe Prodhuesit të Privilegjuar. Nëse çmimi referent është më i ulët se çmimi i fiksuar, Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme ia paguan Prodhuesit të Privilegjuar diferencën. Nëse çmimi

referent është më i lartë se çmimi i fiksuar, Prodhuesi i Privilegjuar ia paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Ripërtëritshme;

- 1.3. Kontrata për Premium – nënkupton një lloj Kontrate për Mbështetje të caktuar financiarisht, ku Prodhuesit të Privilegjuar për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar i paguhet një premium i fiksuar mbi çmimin e tregut nga Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme;
- 1.4. Kontrata për Mbështetje – nënkupton kontratën në bazë të së cilës Prodhuesit të Privilegjuar i jepet mbështetje sipas një Skeme Mbështetëse në formën e një MBE-je, një Kontrate për Premium ose një Kontratë të Diferencës. Një model për çdo lloj Kontrate për Mbështetje hartohet nga Operatori i Energjisë së Ripërtëritshme dhe publikohet pas miratimit nga Rregullatori;
- 1.5. Çmimi referent historik – është çmimi referent i llogaritur në bazë të Metodologjisë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE” nr. 01/2020.
- 1.6. Premiumi i fiksuar maksimal – nënkupton premiumin e fiksuar maksimal, mbi çmimin e tregut, i cili mund të jepet përmes procesit të tenderit konkurrues me kontratë për premiumin;
- 1.7. Çmimi i fiksuar maksimal – nënkupton çmimin maksimal të garantuar që mund t’i ndahet një Prodhuesi të Privilegjuar përmes një procesi të ofertimit konkurrues me një kontratë të diferencës;
- 1.8. Tarifa nxitëse maksimale ose çmimi i garantuar i blerjes – nënkupton çmimin maksimal të garantuar që mund t’i ndahet një Prodhuesi të Privilegjuar përmes procesit të ofertimit konkurrues me një tarifë nxitëse;
- 1.9. Prodhues i Privilegjuar - nënkupton çdo prodhues të energjisë së ripërtëritshme që përfiton nga një skemë mbështetëse;
- 1.10. Çmimi Referent – nënkupton çmimin për orë të vendosur në Tregun Kosovar një-ditë-para që operohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë. Nëse çmimi i caktuar i ditës paraprake nuk mund të përcaktohet, çmimi referent do të përcaktohet nga Rregullatori, përmes akteve nënligjore bazuar në metodologjinë për caktimin e çmimit referent. Në rast se çmimi referent është negativ, ai do të konsiderohet zero për qëllime të barazimit financiar sipas një Kontrate të Diferencës;
- 1.11. Rregullator – nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, e themeluar si agjenci e pavarur sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
- 1.12. Çmimi i fiksuar – nënkupton çmimin përfundimtar që do të përfitojë Prodhuesi i Privilegjuar i energjisë elektrike, si rezultat i ndarjes në një procesi tenderimi konkurrues;
- 1.13. Skema Mbështetëse - një instrument ose mekanizëm mbështetës, i aplikuar me qëllim të stimulimit të përdorimit të energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, duke ulur koston e kësaj energjie, duke rritur çmimin e shitjes së saj, ose duke rritur vëllimin e masës së

energjisë së ripërtëritshme të shitur përmes kuotave të detyrueshme. Instrumente ose mekanizma të tillë mund të jenë mbështetja e investimeve, ulja e taksave ose kompensimi i kostove, skemat e detyrueshme duke përfshirë ato për përdorimin e certifikatave të gjelbra, si dhe forma të mbështetjes direkte në çmim, duke përfshirë tarifatat nxitëse ose çmimin e garantuar të blerjes, ose pagesat e premiumit;

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 3

Parimet kryesore

1. Rregullatori do të caktojë tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal dhe çmimin e fiksuar maksimal në secilin Proces të Ofertimit Konkurrues.
 - 1.1. Premiumi i fiksuar maksimal përdoret kur Procesi i Ofertimit Konkurrues shfrytëzon një kontratë për premium, përmes një premium të fiksuar.
 - 1.2. Çmimi i fiksuar maksimal shfrytëzohet kur Procesi i Ofertimit Konkurrues përdor një Kontratë të Diferencës, nëpërmjet një premium të rrëshqitës simetrik.
 - 1.3. Tarifa nxitëse maksimale përdoret kur Procesi i Ofertimit Konkurrues përdor një mekanizëm të tarifës nxitëse i cili bazohet në çmimin e garantuar të blerjes.
 - 1.4. Ofertat që tejkalojnë tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal ose çmimin e fiksuar maksimal do të përjashtohen nga procesi i ofertimit konkurrues.
2. Rregullatori do të synoj të vendos tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal ose çmimin e fiksuar maksimal në një nivel që lejon konkurrencë të mjaftueshme brenda Procesit të Ofertimit Konkurrues dhe kufizon përfitimet e tepruara të Prodhuesit të Privilegjuar duke siguruar se mund të kontraktohet kapaciteti i mjaftueshëm.
3. Rregullatori do të marrë parasysh kohëzgjatjen e Kontratave për Mbështetje, të përcaktuara për ankandin specifik, për të vendosur tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal ose çmimin e fiksuar maksimal.
4. Në përcaktimin e tarifës nxitëse maksimale, premiumit të fiksuar maksimal ose çmimit të fiksuar maksimal, Rregullatori do t'i referohet, por nuk është i obliguar ose i kufizuar nga:
 - 4.1. Të dhëna të përditësuara nga burime të besueshme;
 - 4.2. Vëllimet dhe kostot e mëhershme nga projektet e mëparshme të ngjashme të energjisë së ripërtëritshme dhe skemat mbështetëse në Kosovë dhe vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet projekteve;
 - 4.3. Rezultatet nga skemat e mëparshme të mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme;

- 4.4. Të dhënat historike për tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe në vende të tjera në Evropë;
- 4.5. Projeksionet e ardhshme të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe vende të tjera në Evropë; dhe
- 4.6. Të dhënat dhe llogaritjet e ndonjë projekti specifik.

Neni 4

Opsionet për të analizuar dhe vendosur Tarifën Nxitëse Maksimale, Premiumin e Fiksuar Maksimal ose Çmimin e Fiksuar Maksimal

1. Rregullatori mund të përdorë, por nuk kufizohet në, një ose një kombinim të opsioneve të mëposhtme për të vendosur tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal dhe çmimin e fiksuar maksimal:
 - 1.1. Vendosjen e tarifës nxitëse maksimale, premiumit të fiksuar maksimal ose çmimit të fiksuar maksimal përmes çmimit referent historik;
 - 1.2. Vendosjen e tarifës nxitëse maksimale, premiumit të fiksuar maksimal ose çmimit të fiksuar maksimal duke përdorur çmimin e tregut të përcaktuar në Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues për të njëjtën teknologji të burimeve të ripërtëritshme; dhe,
 - 1.3. Vendosjen e tarifës nxitëse maksimale, premiumit të fiksuar maksimal ose çmimit të fiksuar maksimal përmes Metodologjisë së Kostos së Niveluar të Energjisë Elektrike.
2. ZRRE-ja mund të përshtas tarifën nxitëse maksimale/premiumin e fiksuar maksimal/çmimin e fiksuar maksimal që rezulton nga metodologjitë e përmendura në nenin 4, paragrafi 1, bazuar në rezultatet nga projekti i mëparshëm i Skemave Mbështetëse, njohurive të ekspertëve dhe përvojës rajonale.

Neni 5

Përcaktimi i Tarifës Nxitëse Maksimale, Premiumit të Fiksuar Maksimal ose Çmimit të Fiksuar Maksimal në Çmimin Referent Historik

1. Tarifa nxitëse maksimale ose çmimi i fiksuar maksimal i vendosur në çmimin referent historik merr në konsideratë të dhënat nga e kaluara, për të vlerësuar kostot e shmangura që rezultojnë nga një projekt.
 - 1.1. Rregullatori do të përdorë "Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE-të" nr. 01/2020, për të vendosur tarifën nxitëse maksimale/çmimin e fiksuar maksimal përmes këtij opsioni.
 - 1.2. Rregullatori mund të përdorë të dhëna nga viti i kaluar ose mesataren e shumë viteve të kaluara për vlerësimin e çmimit referent historik.

- 1.3. Për skemat konkurruese me teknologji specifike, Rregullatori do të përdor teknologjinë dhe profilet e prodhimit të energjisë për projektin specifik në baza ore. Prodhimi i energjisë elektrike do të marrë parasysh të gjitha humbjet deri në pikën e matjes.
- 1.4. Për skemat konkurruese neutrale ndaj teknologjisë, Rregullatori do të përdorë çmimet mesatare referente historike të tregut në baza vjetore.
2. Premiumi i fiksuar maksimal i vendosur në çmimin referent është vendosur në 0, pasi premiumi i fiksuar është një shtesë në një çmim referent të tregut.
 - 2.1. Premiumi i fiksuar maksimal i vendosur përmes kësaj metode, mund të përshtatet siç është paraqitur në nenin 4, paragrafi 2.
3. Rregullatori do të marrë parasysh të dhënat në dispozicion nga tregu një-ditë-para në Kosovë pas funksionalizimit të tij.
4. Tarifa nxitëse maksimale, premiumi i fiksuar maksimal ose çmimi i fiksuar maksimal i vendosur përmes kësaj metode, do të përshtatet siç është prezantuar në nenin 4, paragrafi 2.

Neni 6

Përcaktimi i Tarifës Nxitëse Maksimale, Premiumit të Fiksuar Maksimal ose Çmimit të Fiksuar Maksimal duke përdorur çmimin e tregut të përcaktuar në Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues

1. Rregullatori mund të përdorë këtë metodë kur kushtet e Procesit aktual të Ofertimit Konkurrues nuk ndryshojnë ndjeshëm nga Prosesi i mëparshëm i Ofertimit Konkurrues. Kjo përfshin:
 - 1.1. Teknologji të ngjashme të Procesit të Ofertimit Konkurrues;
 - 1.2. Kontributet në natyrë nga Qeveria e Kosovës (si shfrytëzimi i tokës, kyçja në rrjet etj.);
 - 1.3. Kohëzgjatja e kontratave për mbështetje;
 - 1.4. Pronësia e stabilimentit pas përfundimit të Kontratës për Mbështetje;
 - 1.5. Madhësia dhe kompleksiteti i projektit;
 - 1.6. Kushtet gjeografike dhe moti;
 - 1.7. Kostoja e teknologjisë, materialeve dhe punës;
2. Rregullatori do të përdorë çmimin e tregut të vendosur në Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues, me një mbi-kapacitet prej të paktën 50% të kapacitetit të synuar të Procesit të mëparshëm të Ofertimit Konkurrues.

- 2.1. Nëse Procesi i mëparshëm i Ofertimit Konkurrues nuk ka rezultuar në një mbi-kapacitet prej 50%, atëherë Rregullatori mund të përdorë tarifën e mëparshme nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal ose çmimin e fiksuar maksimal.
3. Tarifa nxitëse maksimale, premiumin i fiksuar maksimal ose çmimi i fiksuar maksimal, i vendosur përmes kësaj metode, mund të përshtatet siç është paraqitur në nenin 4 paragrafi 2.

Neni 7

Përcaktimi i Tarifës Nxitëse Maksimale, Premiumit të Fiksuar Maksimal dhe Çmimit të Fiksuar Maksimal përmes Metodologjisë së Kostos së Nivelizuar të Energjisë Elektrike (Levelized Cost of Electricity - LCOE)

4. Duke përdorur këtë metodë, Rregullatori do të vlerësojë të gjitha kostot e aplikueshme të projektit të bëra gjatë ndërtimit dhe kohëzgjatjen e Kontratës për Mbështetje të projektit, nga këndvështrimi i investitorit. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:
 - 4.1. Kostot e teknologjisë;
 - 4.2. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes;
 - 4.3. Kostot e inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit (përfshirë kostot e transportit të teknologjisë);
 - 4.4. Kostot e kyçjes në rrjet dhe tarifatat për përdorimin e rrjetit;
 - 4.5. Kthimin e arsyeshëm në investim, duke marrë parasysh nivelin e riskut;
 - 4.6. Kostot e financimit dhe kostot kapitale (borxhi, ekuiteti);
 - 4.7. Kostot e aplikueshme të balancimit;
 - 4.8. Kostoja e tokës;
 - 4.9. Kostot e dekomisionimit (nëse është e aplikueshme); dhe,
 - 4.10. Të gjitha tarifatat, ngarkesat dhe taksat e aplikueshme.
5. Rregullatori mund të bazojë vlerësimin e tij në të dhënat nga projektet e ngjashme të zbatuara.
6. Prodhimi i energjisë elektrike do të marrë parasysh të gjitha humbjet deri në pikën e matjes.
7. Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje nga Procesi specifik i Ofertimit Konkurrues, do të konsiderohet si jetëgjatësia e projektit për të vendosur tarifën nxitëse maksimale, premiumin e fiksuar maksimal ose çmimin e fiksuar maksimal përmes metodës LCOE.
8. Premiumin i fiksuar maksimal i vendosur me këtë metodë do të përjashtojë përfitimet financiare nga energjia elektrike e shitur nga prodhuesi në treg përmes kontratës për premium.

- 8.1. Rregullatori mund të përdorë parashikimet e ardhshme ose të dhënat nga e kaluara mbi çmimet e tregut për të vlerësuar fitimet e ardhshme nga energjia elektrike e shitur në treg.
9. Tarifa nxitëse maksimale/çmimi i fiksuar maksimal do të vendoset në LCOE që rezulton nga kjo llogaritje.
10. Tarifa nxitëse maksimale, premiumin i fiksuar maksimal ose çmimi i fiksuar maksimal, i vendosur përmes kësaj metode, mund të përshtatet siç është paraqitur në nenin 4 paragrafi 2.

KAPITULLI II

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E PREMIUMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL DHE ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL

Neni 8

Metoda e llogaritjes përmes Metodologjisë së Kostos së Nivelizuar të Energjisë Elektrike (LCOE)

1. Premiumin i fiksuar maksimal i vendosur përmes Metodologjisë LCOE zbaton ekuacionin e mëposhtëm:

Premiumin i fiksuar maksimal = LCOE_p

$$LCOE_p = \frac{\text{Kostoja totale e projektit} - \text{Përfitimi nga tregu}}{\text{Prodhimi (outputi) total i projektit}}$$

$$\text{Kostoja totale e projektit} = \sum_{t=1}^n \frac{C_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Prodhimi total i projektit} = \sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Përfitimi nga tregu} = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{P_t \times E_t}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

$$LCOE_p = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{C_t - (P_t \times E_t)}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Ku:

LCOE_p Kostoja e Nivelizuar e Energjisë Elektrike, për të vendosur premiumin e fiksuar maksimal;

C_t	Kostot/shpenzimet në vitin t (përfshirë, por pa u kufizuar në shpenzimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 1 të kësaj metodologjie), të bëra gjatë ndërtimit dhe gjatë periudhës së Kontratës për Mbështetje;
E_t	Energjia elektrike e prodhuar në pikën e matjes në vitin t;
P_t	Çmimi mesatar i vlerësuar i energjisë elektrike në vitin t;
r	Norma e zbritjes;
n	Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje, e caktuar për ankandin specifik.

2. Tarifa maksimale e furnizimit dhe çmimi i fiksuar maksimal, të vendosura sipas Metodologjisë LCOE, zbaton ekuacionin e mëposhtëm:

Çmimi maksimal nxitës/fiksuar = LCOE_S

$$LCOE_S = \frac{\text{Kostoja totale e projektit}}{\text{Prodhimi total i projektit}}$$

$$\text{Kostoja totale e jetëgjatësisë} = \sum_{t=1}^n \frac{C_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Prodhimi total i jetëgjatësisë} = \sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}$$

$$LCOE_S = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + O_t + \dots}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Ku:

LCOE_S Kostoja e Nivelizuar e Energjisë Elektrike për të vendosur tarifën nxitëse maksimale/çmimin e fiksuar maksimal;

C_t Kostot/shpenzimet në vitin t (përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 1 të kësaj metodologjie), të bëra gjatë ndërtimit dhe gjatë periudhës së Kontratës për Mbështetje;

E_t Energjia elektrike e prodhuar në pikën e matjes në vitin t;

r Norma e zbritjes;

n Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje e caktuar për ankandin specifik.

KAPITULLI V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 9

Modifikimi

1. Rregullatori ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulle do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 10

Interpretimi

Në rast se ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të lëshoj informacion shpjegues.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregull hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Rregullatorit për Energji dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:

Ymer Fejzullahu , Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtar

Ganiu Buçaj, anëtar